VENDIM
Nr. 288, datë 14.5.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT PREKEN NGA HAPJA DHE SISTEMIMI I RRUGËS "11 NËNTORI", SEGMENTI NGA SHKOLLA "JORGJI DILO" DERI TE "ROTONDA TEK POSTA", TË BASHKISË SË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga hapja dhe sistemimi i rrugës "11 Nëntori", segmenti nga shkolla "Jorgji Dilo" deri te "Rotonda tek Posta", të bashkisë së Elbasanit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Elbasanit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas vlerave të mëposhtme:

a) Për sipërfaqen 4 850.18 (katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë pikë tetëmbëdhjetë) m² truall, në vlerën 19 793 584.6 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër pikë gjashtë) lekë;

b) Për sipërfaqen 1 823.24 (një mijë e tetëqind e njëzet e tre pikë njëzet e katër) m² banesë në vlerën 82 262 765.6 (tetëdhjetë e dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë gjashtë) lekë;

c) Për drufrutorët, në masën 581 601 (pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e një) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 125 803 483.3 (njëqind e njëzet e pesë milionë e tetëqind e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre pikë tre) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Elbasanit, planifikuar në buxhetin e saj.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Elbasanit.
6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.
7. Regjistrimi i ri i pasurive për sipërfaqet 4 850.18 (katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë pikë tetëmbëdhjetë) m² truall, dhe 1 823.24 (një mijë e tetëqind e njëzet e tre pikë njëzet e katër) m² banesë, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, hapja dhe sistemimi i rrugës "11 Nëntori", segmenti nga shkolla "Jorgji Dilo" deri te "Rotonda tek Posta", në bashkinë e Elbasanit, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama